



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 09 Shator 2021

Nr: 111

VENDIMI

“PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72,
73 TË PARTIVE POLITIKE TË DEPOZITUARA NË KQZ”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 09.09.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Kryesues
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia Aleanca Demokristiane, kërkesa ankimore nr.62, datë 23.07.2021
Partia Lëvizja e Legalitetit, kërkesa ankimore nr. 63, datë 23.07.2021;
Partia Balli Kombëtar, kërkesa ankimore nr. 64, datë 23.07.2021;
Partia Ora e Shqipërisë;
Partia Bashkimi Demokrat;
Partia Balli Kombëtar Demokrat;
Partia Kombëtare Konservatore Albania;
Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve;
Partia Demokracia e Re Europiane;
Partia Emigracioni Shqiptar;
Partia Lëvizja Demokratike e Shqipërisë;
Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European, kërkesa ankimore nr. 65, datë 26.07.2021;



Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim, kërkesa ankimore nr. 66, datë 26.06.2021;

Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar, kërkesa ankimore nr. 67, datë 26.07.2021;

Partia e Gjelbër, kërkesa ankimore nr. 68, datë 06.08.2021;

Partia Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen, kërkesa ankimore nr. 69, datë 12.08.2021;

Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, kërkesa ankimore nr. 70, datë 16.08.2021;

Partia Bindja Demokratike, kërkesa ankimore nr. 71, datë 19.08.2021;

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, kërkesa ankimore nr. 72, datë 23.08.2021;

Partia e Unitetit Kombëtar, kërkesa ankimore nr. 73, datë 24.08.2021.

OBJEKTI:

Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr. 62, datë 23.07.2021; nr. 63, datë 23.07.2021; nr. 64, datë 23.07.2021; nr. 65, datë 26.07.2021; nr. 66, datë 26.07.2021; nr. 67, datë 26.07.2021; nr. 68, datë 06.08.2021; nr. 69, datë 12.08.2021; nr. 70, datë 16.08.2021; nr. 71, datë 19.08.2021; nr. 72, datë 23.08.2021; nr. 73, datë 24.08.2021 me objekt: kundërshtimi i vendimit nr. 430, datë 22.07.2021 të KSHZ-së “Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020 si dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre”.

BAZË LIGJORE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 124, 133, 143 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 65 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



Rrethanat e çështjes:

1. Neni 23, i ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, parashikon se partitë politike kanë detyrimin të dorëzojnë raportin financiar 1 (një) herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky raport duhet të dorëzohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës referuar vendimit nr. 14, datë 23.11.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 3, datë 18.01.2012 për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar nga ekspertet kontabël”.
2. Sipas gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se janë të regjistruara 131 (njëqind e tridhjetë e një) parti politike, nga të cilat 106 (njëqind e gjashtë) parti politike nuk e kanë dorëzuar raportin vjetor financiar, për vitin kalendarik 2020, 4 (katër) parti politike kanë dorëzuar raportin vjetor financiar për vitin kalendarik 2020, pas datës 31 Mars 2021, si edhe 21 (njëzet e një) parti politike e kanë dorëzuar raportin vjetor financiar, brenda datës 31 Mars 2021. Nga 106 (njëqind e gjashtë) partitë politike, të cilat nuk kanë dorëzuar raport vjetor financiar janë 11 (njëmbëdhjetë) parti politike që kanë qenë pjesë e zgjedhjeve të datës 25 prill 2021.
3. Me vendimin nr. 430, datë 22.07.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) vendosi:
 - *Marrja e masës administrative, gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për 106 (njëqind e gjashtë) partitë politike që nuk kanë dorëzuar raportin vjetor financiar për vitin kalendarik 2020 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.*
 - *Marrja e masës administrative, gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për 4 (katër) partitë politike që e kanë dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar raportin vjetor financiar 2020 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.*
4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore nr. 62, datë 23.07.2021 Partia Aleanca Demokristiane**. Në kërkesën e saj pretendon se duke u referuar vitit paraardhës, për shkak të situatës pandemike “Covid-19”, kjo parti ka shkëputur vëmendjen e detyrimit ligjor për të dorëzuar raportin financiar. Gjithashtu citojnë se nëse do të kishin marrë një njoftim për kujtesë nga KQZ disa ditë para përfundimit të afatit ligjor për dorëzimin e raportit financiar, nuk do të kishte munguar raportimi në afatin e përcaktuar. Në përfundim Partia Aleanca Demokristiane kërkon ndryshimin e vendimit nr. 430, datë 22.07.2021 të KSHZ dhe heqjen e masës administrative me gjobë.



5. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore me nr. 63, datë 23.07.2021 Partia Lëvizja e Legalitetit**, e cila pretendon se duke u referuar vitit paraardhës dhe çdo viti tjetër, kanë qenë korrekt në dorëzimin e raporteve financiare në afatet e duhura. Pasqyrat financiare për vitin 2020 janë dorëzuar me vonesë për disa arsye si p.sh: keqkuptimi i krijuar nga shtyrja e afatit për në shtator, viti pandemik dhe me kohë pune të kufizuar si dhe ishte vit i reformës zgjedhore dhe i zgjedhjeve duke krijuar ngarkesë dhe keqkuptime në afate. Në përfundim Partia Lëvizja e Legalitetit kërkon ndryshimin e vendimit nr. 430, datë 22.07.2021 të KSHZ dhe heqjen e masës administrative me gjobë.

6. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore me nr. 64, datë 23.07.2021, Partia Balli Kombëtar, Partia Ora e Shqipërisë, Partia Bashkimi Demokrat, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve, Partia Demokracia e Re Europiane, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Lëvizja Demokratike e Shqipërisë**, të cilët pretendojnë se viti 2020 ka qenë një vit jo normal ku për shkak të pandemisë, institucionet private e shtetërore nuk kanë punuar me efikasitet të plotë, ndaj e kundërshtojnë këtë vendim. Gjithashtu citojnë se kanë qenë gjithmonë korrekt në zbatimin e ligjit për dorëzimin e pasqyrave financiare si dhe kanë menduar se do të ketë shtyrje të afatit deri në shtator, sikurse ndodhi edhe për vitin 2019. Në përfundim këto subjekte kërkojnë ndryshimin e vendimit nr. 430, datë 22.07.2021 të KSHZ dhe shtyrjen e afatit për një periudhë një javore për dorëzimin e pasqyrave financiare.

Partia Lëvizja Demokratike e Shqipërisë pretendon se është regjistruar më datë 19 tetor 2020 pranë Gjykatës dhe vendimi ka marrë formë të prerë në nëntor 2020. Për këto arsye kjo parti nuk ka patur asnjë të ardhur dhe asnjë shpenzim për vitin 2020. Në përfundim Partia Lëvizja Demokratike e Shqipërisë kërkon ndryshimin e vendimit nr. 430, datë 22.07.2021 të KSHZ dhe heqjen e sanksionit administrativ për këtë subjekt.

7. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore me nr. 65, datë 26.07.2021**, Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian, e cila pretendon se viti 2020 ka qenë një vit jo normal ku për shkak të pandemisë, institucionet private e shtetërore nuk kanë punuar me efikasitet të plotë, ndaj e kundërshtojnë këtë vendim. Gjithashtu citon se kanë qenë gjithmonë korrekt në zbatimin e ligjit për dorëzimin e pasqyrave financiare si dhe kanë menduar se do të ketë shtyrje të afatit deri në shtator, sikurse ndodhi edhe për vitin 2019. Në përfundim Partia Aleanca Maqedonasve për Integrimin Europian kërkon ndryshimin e vendimit nr. 430, datë 22.07.2021 të KSHZ dhe shtyrjen e afatit për një periudhë një javore për dorëzimin e pasqyrave financiare.



8. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore me nr. 66, datë 26.07.2021, Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim**, e cila pretendon se viti 2020 ka qenë një vit jo normal ku për shkak të pandemisë, institucionet private e shtetërore nuk kanë punuar me efikasitet të plotë, ndaj e kundërshtojnë këtë vendim. Gjithashtu citon se kanë qenë gjithmonë korrekt në zbatimin e ligjit për dorëzimin e pasqyrave financiare si dhe kanë menduar se do të ketë shtyrje të afatit deri në shtator, sikurse ndodhi edhe për vitin 2019. Në përfundim Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim kërkon ndryshimin e vendimit nr. 430, datë 22.07.2021 të KSHZ dhe shtyrjen e afatit për një periudhë një javore për dorëzimin e pasqyrave financiare.
9. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore me nr. 67, datë 26.07.2021, Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar**, e cila pretendon se kjo parti aktivitetin e saj e ka zhvilluar deri në vitin 2009, kur ishte pjesë e procesit zgjedhor. Më pas ndërpreu aktivitetin politik për arsye objektive, pasi mungonte lidhshmëri që t'a bënte të mundur qëndrimin e saj në tregun politik, pa aftësi organizative si edhe mungesa e një eksperience për të ndërtuar një parti konkurruese e me kredenciale për të afruar zgjedhësit. Gjithashtu citojnë se munguan të ardhurat financiare. Financimi shtetëror me para publike është i kushtëzuar nga ecuria e rezultateve në zgjedhjeve dhe në këto kushte Partia PDBMSH nuk përfitoi kurrë financime nga buxheti publik si dhe nuk kanë patur donatorë të huaj apo shoqata të interesuara. Prej vitit 2009, Partia PDBMSH nuk ka funksionuar dhe të ardhurat kanë qenë zero lekë, e për këto arsye ka munguar raporti financiar në KQZ. Për këto arsye kërkojnë shfuqizimin e vendimit 430, datë 22.07.2021, të KSHZ-së.
10. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore me nr. 68, datë 06.08.2021, Partia e Gjelbër**, e cila kërkon të rishikohet kjo masë administrative për dorëzimin me vonesë të pasqyrave financiare për vitin 2020 me argumentin se vonesa ka qenë për arsye objektive të lidhura këto me situatën e rënduar pandemike nga “Covid-19” në këtë periudhë. Për shkaqe të njohura, stafet e punës kanë funksionuar më së shumti online, si dhe shumë prej tyre kanë patur shpërndarje të përkohshme nga puna për shkak të prekjës nga virusi. Në përfundim Partia e Gjelbër kërkon ndryshimin e vendimit nr. 430, datë 22.07.2021 të KSHZ dhe shtyrjen e afatit për dorëzimin e pasqyrave financiare.



11. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore me nr. 69, datë 12.08.2021, Partia Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen**, e cila pretendon se e ka dërguar këtë raport më datë 31.03.2021, vërtetuar me shkresën nr. 660/1, datë 09.08.2021 të Filialit të Postës, Sarandë. Në përfundim Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen kërkon shfuqizimin e vendimit 430, datë 22.07.2021, të KSHZ-së dhe heqjen e masës administrative për këtë subjekt.
12. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore me nr. 70, datë 16.08.2021, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar**, e cila pretendon se është një parti që gjithmonë ka respektuar detyrimet ligjore në lidhje me raportimet në KQZ, e madje ka qenë shumë e hapur për të bashkëpunuar me çdo ekspert auditues që KQZ ka dërguar. Mosrespektimi i afatit për raportimin financiar ka lindur si pasojë e një viti të vështirë që ka kaluar bota për shkak të “Covid-19”, e cila ka detyruar një pjesë të mirë të drejtuesve të partisë të qëndrojnë të izoluar duke mos pasur mundësi të respektojnë afatet ligjore. LZHK shpreh angazhimin se këtë detyrim do ta përmbushë sa më shpejt. Nga ana tjetër konstatojnë se KSHZ në lidhje me masën e gjobës është i padrejtë dhe i pabazuar në ligj ku sipas tyre Ligji Për Partitë Politike nuk ka parashikuar një afat kohor të dorëzimit të këtij raportimi dhe se nuk e kanë ditur se raporti duhej të dorëzohej brenda datës 31 mars 2021. Në përfundim Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar kërkon shfuqizimin e vendimit 430, datë 22.07.2021, të KSHZ-së dhe heqjen e masës administrative për këtë subjekt.
13. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore me nr. 71, datë 19.08.2021, Partia Bindja Demokratike**, e cila pretendon se gjithmonë ka respektuar detyrimet ligjore në lidhje me raportimet më KQZ-në e madje ka qenë shumë e hapur për të bashkëpunuar me çdo ekspert auditues që KQZ ka dërguar. Krahas mosrespektimit të afatit për raportimin për shkak të vitit të vështirë të pandemisë, ngrejnë pretendimin e një vendimmarrje jo të drejtë dhe të pabazuar në ligj të vendimit të KSHZ-së. Sipas tyre Ligji Për Partitë Politike nuk ka parashikuar një afat kohor të dorëzimit të këtij raportimi dhe se nuk e kanë ditur se raporti duhej të dorëzohej brenda datës 31 mars 2021 dhe se vendimi nr.14, datë 23.11.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.3, datë 18.01.2012 për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar nga ekspertët kontabël”, në pikën 1 të dispozitivit citohet përcaktohet se *Partitë politike duhet të dorëzojnë pranë KQZ-së raportet financiare vjetore, brenda datës 31 Mars 2012, pra ky afat duhet të zbatohet për vitin 2012 dhe jo në vazhdim edhe për vitin 2020*. Në përfundim Partia Bindja Demokratike kërkon shfuqizimin e vendimit 430, datë 22.07.2021, të KSHZ-së dhe heqjen e masës administrative për këtë subjekt.



14. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore me nr. 72, datë 23.08.2021, Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë**, e cila pretendon se ky subjekt politik vazhdon ende të mbetet pa një kryetar partie ku normalisht mungon organizimi e funksionimi i saj dhe nuk ka marrë pjesë në zgjedhje që prej vitit 2017. Zana Prela në cilësinë e Sekretares së Përgjithshme pretendon se nuk ka patur eksperiencën e duhur për të patur dijeni për dorëzimin e raporteve vjetore financiare për vitin kalendarik 2020, e gjithashtu ngre pretendimin se nuk ka marrë asnjë njoftim nga KQZ-ja për dorëzimin e raporteve. Në përfundim Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë kërkon ndryshimin e vendimit 430, datë 22.07.2021, të KSHZ-së dhe heqjen e masës administrative për këtë subjekt.
15. Kundër këtij vendimi ka paraqitur **kërkesë ankimore me nr. 73, datë 24.08.2021, Partia e Uniteti Kombëtar**, e cila pretendon se KQZ për çdo vit ka caktuar ekspert kontabël, i cili mban kontakte me partitë politike për të bërë raportet vjetore financiare, ndërsa këtë vit nuk kanë patur. Për 20 vite me radhë nuk kanë marrë asnjë fond nga buxheti i shtetit dhe nuk kanë patur asnjë burim financimi që të pasqyrojnë në raportin financiar duke shënuar për çdo vit faktin real zero hyrje dhe zero shpenzime. Gjithashtu ngrenë pretendimin se gjate viteve 2017-2019 kanë paguar ekspertët e KQZ-së nga të ardhurat personale, ndërsa vitin 2020 e konsideruan të papranueshme bërjen e kësaj pagese. Në përfundim Partia e Unitetit Kombëtar kërkon shfuqizimin e vendimit nr. 430, datë 22.07.2021 të KSHZ si dhe heqjen e masës administrative për këtë subjekt.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) është organi kompetent për të vendosur sanksione administrative ndaj partive politike në lidhje me mosdorëzimin e pasqyrave financiare të Partive Politike sipas nenit 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe neneve 23 dhe 23/4 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.
2. KSHZ, në vendimin nr. 430, datë 22.07.2021 “Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të Partive politike për vitin kalendarik 2020 dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre”, në arsyetimin e tij i referohet vendimit nr.14, datë 23.11.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 3, datë 18.01.2012 për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar nga ekspertët kontabël”, i cili përcakton datën 31 Mars për dorëzimin e raporteve financiare të



Partive Politike. Vendimi i sipërcituar në dispozitivin e tij përcakton se, në lidhjen 2 të vendimit nr. 3, datë 18.01.2012 bëhen këto ndryshime: Para pikës 1 shtohet pika 01 Hyrje me këtë përmbajtje: “Partitë politike duhet të dorëzojnë pranë KQZ-së **raportet financiare vjetore, brenda datës 31 mars 2012**” ndërsa në arsyetim e tij i referohet legjislacionit tatimor të Republikës së Shqipërisë i cili përcakton se afati për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore pranë Institucionit të Tatimeve bëhet Brenda datës 31 Mars të çdo viti kalendarik. Për analogji, edhe afati për dorëzimin e raporteve financiare vjetore nga partitë politike në KQZ do të jetë data 31 Mars.

3. KAS, vlerëson se në dispozitat e vendimit të mësipërm ka disa pasaktësi të cilat mund të krijojnë konfuzion dhe paqartësi në zbatimin e tij nga partitë politike. Për këtë arsye, KAS vlerëson se KSHZ / Komisioni Rregullator në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit financiar dhe e Auditit të Brendshëm duhet të marrin masa për nxjerrjen një akti të përditësuar ku të përfshihen qartësisht të gjitha procedurat dhe afatet që duhet të ndjekin Partitë Politike për dorëzimin e pasqyrave financiare.
4. Viti 2020 ka qenë vit pandemik për shkak të virusit “Covid 19” dhe ende sot vendi ndodhet në periudhë pandemie. Në gjykimin e KAS, duke qenë në këto kushte dhe duke pasur në konsideratë faktin se në asnjë nga vitet e mëparshme nga ana e KQZ-së nuk janë aplikuar sanksionet me gjobë për shkak të vonesave të kësaj natyre, do të ishte më e pranueshme që KQZ-ja, të njoftonte paraprakisht partitë politike ose përfaqësuesit e tyre për dorëzimin e pasqyrave financiare, madje të konsideronte edhe shtyrjen e afatit nëse një gjë e tillë do ishte kërkuar nga Partitë Politike, sikundër KQZ veprroi në rastin e vendimit nr. 258, datë 21.04.2021 të KSHZ “Për shtyrjen e auditimit për fondet e përfituara dhe shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020 nga Partitë Politike”, me anë të të cilit vendosi shtyrjen e këtij afati deri në muajin shtator 2021.
5. Gjatë hetimit administrativ në KAS, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se Partia Konservatore Kombëtare Albania, Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar dhe Partia Ora e Shqipërisë edhe pas vendosjes së sanksionit administrativ i kanë depozituar pasqyrat financiare. Pra, këto parti politike janë vënë në lëvizje dhe kanë bashkëpunuar me KQZ-në, ndryshe nga shumica e subjekteve ankimore, të cilët edhe pas vendosjes së sanksioneve me gjobë, ende nuk i kanë depozituar pasqyrat financiare.
6. Neni 23/4 i ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike” përcakton se shkelja e afatit të dorëzimit të raportit financiar në kohën e duhur apo paraqitja e raporteve në shkelje të formateve të standardizuara, të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 50.000 deri në 100.000 lekë. KAS vlerëson se KSHZ duhet të merrte parasysh faktin se kjo është hera e



parë që KQZ-ja vendos sanksion administrativ për mosdorëzimin e pasqyrave financiare për vitin kalendarik për partitë politike. Në këto kushte KSHZ, duhet ta kishte konsideruar këtë fakt si rrethanë lehtësuese dhe për këtë arsye nuk duhet të vendoste sanksionin administrativ në vlerën maksimale që përcakton ligji. Në këtë mënyrë do të ishte përmbushur edhe parimi se ligji ka qëllim edukues dhe jo ndëshkues.

7. Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka dorëzuar pasqyrat financiare brenda datës 31.03.2021. Ky fakt vërtetohet nga shkresa nr.660/1 prot., datë 09.08.2021 filialit të Postës Shqiptare Sarandë ku përcakton të dhëna për objektin e postuar në datën 31.03.2021, ora 14:43 me barcod RR388528570AA. Në këto kushte, ky subjekt politik konsiderohet se e ka përmbushur në afat detyrimin ligjor për dorëzimin e pasqyrave financiare dhe për këtë arsye gjoba e aplikuar ndaj tij nga KSHZ është e paligjshme dhe duhet të shfuqizohet.
8. KAS, konsideron se duhet marrë në konsideratë edhe pretendimi i ngritur nga përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Demokratike e Shqipërisë. Konkretisht, nga verifikimi i regjistrit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se kjo parti është regjistruar pranë kësaj Gjykate në datën 19.10.2020 dhe vendimi ka marrë formë të prerë në datën 03.11.2020. Me vendimin nr. 28, datë 05.02.2021 të KSHZ, Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Duke qenë në këto kushte subjekti në fjalë nuk ka patur detyrim të depozitohet në KQZ pasqyrat financiare pasi nuk ka patur veprimtari fiskale si dhe nuk ka kryer asnjë shpenzim. Për këto arsye edhe gjoba e aplikuar ndaj tij nga KSHZ është e paligjshme dhe duhet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE:

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 430, datë 22.07.2021 “Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020 si dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.



2. Pranimin e kërkesës ankimore të subjektit zgjedhor “Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, dhe heqjen e sanksionit administrativ.
3. Pranimin e kërkesës ankimore të subjektit “Partia Lëvizja Demokratike e Shqipërisë” dhe heqjen e sanksionit administrative.
4. Pranimin pjesërisht të kërkesave ankimore të subjekteve “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” dhe “Partia Ora e Shqipërisë” dhe vendosjen e sanksionit administrativ në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë
5. Rrëzimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Partia Lëvizja Legalitetit” dhe “Partia e Gjelbër” dhe lënien në fuqi të sanksionit administrativ në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
6. Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr.430, datë 22.07.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për subjektet Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, Partia Balli Kombëtar, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve, Partia Demokracia e Re Europiane, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Aleanca Maqedonasve për Integrimin Europian, Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim, Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman Shqiptar, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Partia Bindja Demokratike, Partia Popullore Kristian Demokrate e Shqipërisë dhe Partia e Unitetit Kombëtar dhe vendosjen e sanksionit administrativ në shumën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Tiranë brenda 45 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Elvin LAKO - Kryesues

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

